



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK****PROJEKTVENDIM**

NR. _____, DATË ____/____/202__

PËR**MIRATIMIN E NORMAVE TË FURNIZIMIT ME UNIFORMË TË PUNONJËSVE
TË POLICISË BASHKIAKE**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 19.6.2024 Për një ndryshim në vendimin nr. 494, datë 24.8.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake”, dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Policisë Bashkiake, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e normave të furnizimit me uniformë të punonjësve të Policisë Bashkiake sipas lidhje nr. 1, bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Policisë Bashkiake.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE**Drejtör**

Alncida Rroshi

DREJTORIA E POLICISË BASHKIAKE**Drejtör**

Vasip Çopa

KRYETAR

Emiriana Sako

NORMAT E UNIFORMËS PËR POLICINË BASHKIAKE - DURRËS

NR	EMËRTIMI I ARTIKUJVE TË UNIFORMËS			
	Uniforma sherbimi dimerore			
I	Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmishë, kravatë, kapele, këpucë)	Njësia	Sasia	Afati/Vite
1	Xhaketë ngjyrë blu të errët	Copë	1	2
2	Pantallona ngjyrë blu të errët	Copë	2	2
3	Këmishë me mëngë të gjata ngjyrë e kaltër	Copë	2	1
4	Kravatë blu e errët	Copë	2	2
5	Kapele blu e errët	Copë	2	2
6	Këpucë gjysma,uniforme	Palë	1	1
7	Pulovër blu e errët golf me zinxhir	Copë	1	2
8	Xhup blu i errët	Copë	1	3
9	Këpucë me qafa	Palë	1	2
10	Bluzë e brendëshme dimri e trikotuar,ngjyra e zezë	Copë	2	3
11	Bluzë me mëngë të gjata, blu e errët	Copë	2	1
12	Pelerna e shiut	Copë	1	3
13	Doreza lëkure	Palë	1	5
	Uniforma shërbimi verore			
II	Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmishë, kravatë, kapele, këpucë)	Njësia	Sasia	Afati/Vite
1	Pantallona ngjyrë blu e errët.	Palë	2	2
2	Fund ngjyrë blu e errët	Copë	2	2
3	Këmishë me mëngë të shkurtra ngjyrë e kaltër	Copë	2	1
4	Këpucë gjysma, vere.(për meshkuj e femra)	Palë	1	1
5	Kapele tip sportive ngjyra blu e errët	Copë	2	1
6	Bluzë me mëngë të shkurtra e trikotuar,blu e errët.	Copë	2	1
II/1	Uniforma e Shërbimit për përdoruesit e biçikletave (pantallona, bluzë, atlete)	Njësia	Sasia	Afati/Vite
1	Bluzë me mëngë të shkurtra ngjyrë e bardhë.	Copë	2	1
2	Pantallona të shkurtra ngjyrë blu e errët	Copë	2	1
3	Atlete ngjyrë blu të errët	Palë	1	1
4	Bluzë e brendëshme verore ,ngjyra e zezë	Copë	2	3
5	Rrip mesi ngjyrë e zezë.	Copë	1	3
6	Jelek fosforeshent	Copë	1	1

Uniforma Ceremoniale		Njësia	Sasia	Afati/Vite
III	Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmishë, kravatë, kapele, këpucë, shiritat, dorezat, rrip mesi+rrip krahëqafë)			
1	Xhaketë ngjyrë blu të errët	Copë	1	6
2	Pantallona ngjyrë blu të errët	Palë	2	6
3	Këmishë me mëngë të gjata ngjyrë e kaltër	Copë	2	6
4	Kravatë blu e errët	Copë	2	6
5	Kapele blu e errët	Copë	2	6
6	Shiritat në formë gërsheti ngjyra (ari, argjëndi,kaltër), me maja metalike.	Copë	2	6
7	Këpucë gjysma,uniforme	Copë	1	6
8	Doreza të bardha	Palë	1	6
9	Rripi mesi + rrip krahëqaf i bardhë	Copë	2	2
IV	Shënjat Dalluese	Copë	1	6
1	Shënja e supit (Spaleta me shirita ngjyrë,ari,argjëndi,kaltër)	Njësia	Sasia	Afati/Vite
2	Shënja e gjoksit (Numër personal)	Palë	2	2
3	Shënja e krahut	Copë	2	2
		Copë	3	2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E POLICISË BASHKIAKE**

RELACION

**PËR
MIRATIMIN E NORMAVE TË FURNIZIMIT ME UNIFORMË TË PUNONJËSVE
TË POLICISË BASHKIAKE**

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, vendimit nr. 494, datë 24.08.2023, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake”, ndryshuar me Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 19.6.2024 Për një ndryshim në vendimin nr. 494, datë 24.8.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake”, vendimit nr. 452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”, Policia Bashkiake parashtron relacionin si më poshtë vijon:

Policia Bashkiake ushtron detyrat dhe funksionet e saj në bazë të ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, akteve nënligjore të dala në zbatim të tij si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, që ngarkojnë Policinë Bashkiake për kryerjen e këtyre detyrave dhe funksioneve.

Për zbatimin, përmbushjen e detyrave të përditëshme dhe ato specifike, për të ushtruar funksionet me të cilat i ngarkon ligji, ndjehet domosdoshmëri pajisja e efektivit, pjesë përbërëse e Policisë Bashkiake me uniformën dhe pajisjet e përshtatshme.

Referuar nenit 46, të ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, punonjësi i Policisë Bashkiake kryen detyrat e shërbimit me uniformë dhe shenja dalluese të veçanta.

Stema dhe shenjat dalluese përdoren në uniformën e Policisë Bashkiake. Punonjësi i Policisë Bashkiake përdor uniformën dhe shenjat dalluese vetëm gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj. Punonjësi i Policisë Bashkiake gjatë kryerjes së detyrës identifikohet me dokumentin individual të identifikimit.

Policia Bashkiake në çdo bashki ka uniformë të njëjtë, të ndryshme nga çdo strukturë tjetër policore.

Uniforma, shenjat dalluese dhe modeli i dokumentit individual të identifikimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 19.6.2024 Për një ndryshim në vendimin nr. 494, datë 24.8.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake", ndër të tjera, janë miratuar uniformat dhe shenjat dalluese të Policisë Bashkiake.

Uniforma do të jetë e ndarë në 3 lloje: 1. Uniforma shërbimi dimërore; 2. Uniforma shërbimi verore; 3. Uniforma ceremoniale.

Përsa i përket përcaktimit të normave të përdorimit të uniformës jemi referuar edhe në aktet ligjore dhe nënligjore që ekzistojnë për strukturat analoge në vend të cilat përdorin uniformë si: Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës. Gjithashtu, jemi konsultuar dhe kemi marrë mendimin e specialistëve të fushës, si dhe jemi mbështetur në praktikën disa vjeçare të funksionimit të Policisë Bashkiake, si strukturë me uniformë në përbërje të Bashkisë së Durrësit.

Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij materiali pasqyrohen normat e përdorimit të veshmbathjeve të strukturës së Policisë Bashkiak

Vlerësojmë se miratimi i normave të përdorimit të uniformës të Policisë Bashkiake, i shërben paraqitjes dinjitoze gjatë kryerjes së detyrës.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 19.6.2024 Për një ndryshim në vendimin nr. 494, datë 24.8.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake", normat e furnizimit me uniformë të punonjësve të Policisë Bashkiake miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak.

Për sa më sipër kërkojmë nga ju:

1. Miratimin e normave të furnizimit me uniformë të punonjësve të Policisë Bashkiake sipas lidhje nr. 1, bashkëlidhur.

Ju falenderojmë paraprakisht për mirëkuptimin,

DREJTOR

Vasip Çopa



NORMAT E UNIFORMËS PËR POLICINË BASHKIAKE - DURRËS

NR	EMËRTIMI I ARTIKUJVE TË UNIFORMËS			
I	Uniforma sherbimi dimerore Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmishë, kravatë, kapele, këpucë)	Njësia	Sasia	Afati/Vite
1	Xhaketë ngjyrë blu të errët	Copë	1	2
2	Pantallona ngjyrë blu të errët	Copë	2	2
3	Këmishë me mëngë të gjata ngjyrë e kaltër	Copë	2	1
4	Kravatë blu e errët	Copë	2	2
5	Kapele blu e errët	Copë	2	2
6	Këpucë gjysma,uniforme	Palë	1	1
7	Pulovër blu e errët golf me zinxhir	Copë	1	2
8	Xhup blu i errët	Copë	1	3
9	Këpucë me qafa	Palë	1	2
10	Bluzë e brendëshme dimri e trikotuar,ngjyra e zezë	Copë	2	3
11	Bluzë me mëngë të gjata, blu e errët	Copë	2	1
12	Pelerna e shiut	Copë	1	3
13	Doreza lëkure	Palë	1	5
II	Uniforma shërbimi verore Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmishë, kravatë, kapele, këpucë)	Njësia	Sasia	Afati/Vite
1	Pantallona ngjyrë blu e errët.	Palë	2	2
2	Fund ngjyrë blu e errët	Copë	2	2
3	Këmishë me mëngë të shkurtra ngjyrë e kaltër	Copë	2	1
4	Këpucë gjysma, vere.(për meshkuj e femra)	Palë	1	1
5	Kapele tip sportive ngjyra blu e errët	Copë	2	1
6	Bluzë me mëngë të shkurtra e trikotuar,blu e errët.	Copë	2	1
II/1	Uniforma e Shërbimit për përdoruesit e biçikletave (pantallona,bluzë,atlete)	Njësia	Sasia	Afati/Vite
1	Bluzë me mëngë të shkurtra ngjyrë e bardhë.	Copë	2	1
2	Pantallona të shkurtra ngjyrë blu e errët	Copë	2	1
3	Atlete ngjyrë blu të errët	Palë	1	1
4	Bluzë e brendëshme verore ,ngjyra e zezë	Copë	2	3
5	Rrip mesi ngjyrë e zezë.	Copë	1	3
6	Jelek fosforeshent	Copë	1	1

Uniforma Ceremoniale		Njësia	Sasia	Afati/Vite
III	Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmishë, kravatë, kapele, këpucë, shiritat, dorezat, rrip mesi+rrip krahëqafë)			
1	Xhaketë ngjyrë blu të errët	Copë	1	6
2	Pantallona ngjyrë blu të errët	Palë	2	6
3	Këmishë me mëngë të gjata ngjyrë e kaltër	Copë	2	6
4	Kravatë blu e errët	Copë	2	6
5	Kapele blu e errët	Copë	2	6
6	Shiritat në formë gërsheti ngjyra (ari, argjëndi,kaltër), me maja metalike.	Copë	1	6
7	Këpucë gjysma,uniforme	Palë	1	6
8	Doreza të bardha	Copë	2	2
9	Rripi mesi + rrip krahëqaf i bardhë	Copë	1	6
IV	Shënjat Dalluese	Njësia	Sasia	Afati/Vite
1	Shënja e supit (Spaleta me shirita ngjyrë,ari,argjëndi,kaltër)	Palë	2	2
2	Shënja e gjoksit (Numër personal)	Copë	2	2
3	Shënja e krahut	Copë	3	2